



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA  
DEPARTAMENTI I GJUHËS GREKE



PROGRAMI MËSIMORI LËNDËS  
Praktikum i Gjuhës B1

**Ngarkesa në orë/kredite:** 80 orë mësimore, 8 kredite: / 80 seminare

**Viti / Semestri :** Viti I, semestri I

**Lloji i lëndës:** Lëndë e detyrueshme

**Programi i studimit:** Bachelor në “Përkthim dhe interpretim në gjuhë greke dhe angleze”

**Kodi i etikës:** Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

**Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës:** [sofia.delijorgji@unitir.edu.al](mailto:sofia.delijorgji@unitir.edu.al)

[isida.metaj@unitir.edu.al](mailto:isida.metaj@unitir.edu.al)

**PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:**

**Objektivat e përgjithshme lëndore:** Ky kurs synon t’i bëjë studentët të aftë për të përvetësuar sa më mirë gjuhën e folur dhe të shkruar greke. Ata duhet të jenë në gjendje të fusin në fjali fjalë dhe struktura të reja gramatikore. Shprehia e të folurit realizohet nëpërmjet përshkrimit të figurave në fillim të njësive, duke nxitur mendimin e pavarur të studentëve.

**Objektivat specifike lëndore:**

1. Ky kurs do të identifikojë dhe analizojë në mënyrë të detajuar të gjitha konceptet themelore dhe strukturat gjuhësore të gjuhës greke, të tilla si procesi i formimit të fjalëve të reja dhe i atyre ekzistuese; pjesët e ligjëratës dhe tipat e ndryshëm të fjalëve, bashkë me nën-kategorizimin e tyre; sistemin emëror dhe foljor etj.

**Rezultatet e pritshme:**

Në fund të këtij kursi studenti do të jetë i aftë të analizojë pjesët përbërëse në nivel të fjalës; të kategorizojë fjalët varësisht nga struktura dhe mënyra e formimit të tyre; të dallojë konceptet themelore të analizës gramatikore në përgjithësi dhe të analizës së fjalës në veçanti; të realizojë analizë morfologjike të fjalës; të kategorizojë fjalët varësisht nga përfshirja e tyre në një tip të caktuar fjalësh, duke u mbështetur në formën dhe në kuptimin e tyre.